

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrenimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-240306/21 dt. 08.11.2021, për riaplikim të kërkesës së kushteve ndërtimore 05-350/02-120672/21 dt. 25.06.2021, në emër të pronarëve: Betim Tafilaj dhe “Pozhegu Brothers” sh.p.k me seli në Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811251032 me investitorin “Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer” sh.p.k. me seli në Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811432591, me pronar Qazim Asllanaj, për caktim e kushteve ndërtimore dhe për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit afaristo-shumëbanesorë “Rezidenca 4”, në kuadër të bllokut urban “B16”, të tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 03.12.2021, merr këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarëve:** Betim Tafilaj dhe “Pozhegu Brothers” sh.p.k me seli në Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811251032 me investitorin “Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer” sh.p.k me seli në Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811432591, me pronar Qazim Asllanaj, 05 nr. 350/02-240306/21 dt. 08.11.2021, për riaplikim të kërkesës së kushteve ndërtimore 05-350/02-120672/21 dt. 25.06.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin kompleksit afaristo-shumëbanesorë “Rezidenca 4”, gjegjësisht 5 (pesë) ndërtesa: “Ndërtesa B16/01” me etazhitet 2B+P+7, “Ndërtesa B16/02” me etazhitet 2B+P+8, “Ndërtesa B16/03” me etazhitet 2B+P+8, “Ndërtesa B16/04” me etazhitet 2B+P+7 dhe “Aneksi B16/A” me etazhitet 2B+0, në kuadër të bllokut urban “B16”, të tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Mati 1”, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 588-16 dhe 588-23; ZK Matiçan.

**II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet dhe trajtohet sipas:**  
Planit Rregullues “Mati 1”, miratuar me: Vendimin 01 nr.35 – 14451 dt. 21.06.2005, Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01nr.35-642 dt. 01.04.2010 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-1678 dt. 20.07.2011, ku sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë të jetë “Zonë mikse”;  
Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është e planifikuar me destinim “Ndërtim i lartë”;  
Vendimit 14 nr.350/05 – 0069714/18 dt. 22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës “Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane”;

Pronari dhe investitori për kriteret dhe parametrat urban, si dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes “Informatë nga Plani Rregullues Mati 1 – PZHU” me referencë nr.04-350/01-72493/21 dt.22.04.2021, të lëshuar 06.05.2021 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:**

- Numri, sipërfaqet, pronarët dhe klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:
  - nr. 588-16, me  $S=8106m^2$ , me pronar Betim Tafilaj..... "Arë e klasit 5";
  - nr. 588-23, me  $S=288m^2$ , me pronar "Pozhegu Brothers" sh.p.k..... "Arë e klasit 5";Sipërfaqja totale  $S=8394m^2$ .
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura, bazuar edhe në incizimin gjeodezik, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Janë toka urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi të konsiderueshme nga drejtimi veri-jug, me disnivel  $\sim 6m'$ ;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është në rrugën ekzistuese dhe e planifikuar;
- Parcela kadastrale e lartcekur shtrihet brenda ngastrës ndërtimore "L" dhe pjesërisht në rrugën e planifikuar "G" (përmes parcelës kadastrale nr. 588-23) të Planit Rregullues "Mati 1";
- Në kuadër të perimetrit prej  $50m'$  të parcelave kadastrale, përfshihen ndërtesa individuale banimore, ndërtesa shumëbanesore, etj.;

**IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e kompleksit me 5 (pesë) ndërtesa shumëbanesore dhe afariste – "Ndërtesa B16/01" me etazhitet 2B+P+7, "Ndërtesa B16/02" me etazhitet 2B+P+8, "Ndërtesa B16/03" me etazhitet 2B+P+8, "Ndërtesa B16/04" me etazhitet 2B+P+7 dhe "Aneksi B16/A" me etazhitet 2B+0, në kuadër të bllokut urban "B16", të tërësisë "L", të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:**

- Organizimi me qasje në kompleks, pozicionimi, gabaritet dhe etazhitetet e ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelave, rrugët e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – "zgjidhja urbane", bashkangjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste", konkretisht parcelat kadastrale të përfshira-të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:
  - nr.588-16, ZK. Matiçan, me  $S=5003.0m^2$ ;
  - nr.588-23, ZK. Matiçan, me  $S=288.0m^2$ ;Sipërfaqe totale  $S=5291.0m^2$ ;
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste", konkretisht parcelat kadastrale të përfshira-të trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:
  - nr. 588-16, ZK. Matiçan, me  $S=1058.0m^2$ ;Sipërfaqe totale  $S=1058.0m^2$ ;
- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelës ndërtimore, planifikohet të realizohen/ndërtohen ndërtesat shumë banesore dhe afariste, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:
  - Ndërtesa "B16/01",  $S=3890.12m^2 / 2963.60m^2$  mbi tokë +  $926.52m^2$  nën tokë; etazhitet 2B+P+7;
  - Ndërtesa "B16/02",  $S=5937.11m^2 / 4864.71m^2$  mbi tokë +  $1072.40m^2$  nën tokë; etazhitet 2B+P+8;
  - Ndërtesa "B16/03",  $S=5486.49m^2 / 4469.69m^2$  mbi tokë +  $1016.80m^2$  nën tokë; etazhitet 2B+P+8;
  - Ndërtesa "B16/04",  $S=5269.58m^2 / 4209.56m^2$  mbi tokë +  $1060.02m^2$  nën tokë; etazhitet 2B+P+7;
  - Ndërtesa "Aneksi B16/A",  $S=2044.30m^2 / 0.00m^2$  mbi tokë +  $2044.30m^2$  nën tokë; etazhitet 2B+0

**Sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore:  $S=22627.60m^2$ / ku prej tyre  $16507.56m^2$  janë mbi tokë dhe  $6120.04m^2$  nën tokë.**

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave, sipas planit rregullues, të jetë për “banim” si dhe hapësira afariste, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj.(sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas planit rregullues “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban, është “VII-IX, kurse i propozuar dhe i miratuar është “Ndërtesa B16/01” me etazhitet 2B+P+7, “Ndërtesa B16/02” me etazhitet 2B+P+8, “Ndërtesa B16/03” me etazhitet 2B+P+8, “Ndërtesa B16/04” me etazhitet 2B+P+7 dhe “Aneksi B16/A” me etazhitet 2B+0;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), sipas Planit Rregullues “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban, për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabaritit në përdhese ose suterren, është max.40%, si dhe duke respektuar Vendimin e Kryetarit të Prishtinës për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në zonat urbane dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

**Parcela ndërtimore - Blloku “B16”**

$S = 5291.0 \times 0.4 = 2116.40m^2$ ; / lejuar sipas planit rregullues

$S = 1869.97m^2$ ; /sipas projekt propozimit

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), sipas Planit Rregullues “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, është max.60%, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

**Parcela ndërtimore - Blloku “B16”**

$S = 5291.0 \times 0.6 = 3174.60m^2$ ; / lejuar sipas planit rregullues

$S = 3060.02m^2$ ; /sipas projekt propozimit

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ) është max. 10%, sipas planit rregullues, me gjelbërim të lartë dhe të ultë dhe sipas Vendimit 01 nr. 031 - 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:

**Parcela ndërtimore - Blloku “B16”**

$S = 5291.0 \times 0.4 = 2116.40m^2$ ; / sipas Vendimit të Kryetarit

$S = 1587.30m^2 + 530.02m^2$ ; /sipas projekt propozimit 30% në tokë + 10% në kulme;

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues “Mati 1”, është maksimum 2.6. Koeficienti ndërtimor i parcelave kadastrale të bashkuara brenda vijës rregulluese–parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën  $\pm 0.00$ , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë-suterren, dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrome, dhe kjo sipërfaqe do të jetë:

**Parcela ndërtimore - Blloku “B16”**

$A: S = 5291.0 \times 2.6 = 13756.60m^2$ ; / lejuar sipas planit rregullues

$S = 16507.56m^2$ ; / sipas projekt propozimit

- Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me koeficient të ndërtimit, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese (deri në 20% të parcelës ndërtimore) mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje dhe bazuar në parcelën ndërtimore, sipërfaqja prej 20% do të jetë,  $S=5291.0 \times 0.2$  (20%) =  $1058.2m^2$ , ndërsa sipërfaqja e parcelave jashtë vijës rregulluese sipas dispozitës urbanistike është  $1058m^2$ ,

$B: 1058 \times 2.6 = 2750.80m^2$

**$A+B = 13756.60 + 2750.80 = 16507.4$  (sipërfaqe ndërtimore e lejuar mbi tokë)**

**$S = 16507.56m^2$ ; / sipas projekt propozimit /**

- Bazuar në kriteret e planit rregullues, tipi i mbulimt d4, definohet në zonat me dendësinë më të lartë. Kjo mundëson ndërtimin e objektit me një gjatësi prej maksimum 40 m'. dhe sipërfaqe te

lire prej 0,4 x h-lartësia e ndërtesës ose se paku 3m'nga kufiri i parcelës. Thellësia maksimale e ndërtesës është 16m'.

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit, nga rruga-niveli i terrenit duhet të jenë 1.2m', ndërsa për objektet me terren të pjerrët me kënde i cili e përcjellë këndin e rrugës e të cilat në përdhësë kanë destinim veprimtari afariste kuota mund të jetë më lartë se kuota e trotuarit më së tepërmi 0.20m';
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues, të prezantuar në Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane" të kompleksit;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve (shfrytëzuesve) të ndërtesave kolektive të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, standardi i parkimit respektivisht i garazhimit është 1.0 (vend garazhi) sipas Planit Rregullues "Mati I" ose min.1.0 vendparkim sipas Rregullores MMPH nr.03/2016, për një banesë. Për pjesën e afarizmit min. 1 vendparkim për 30m<sup>2</sup> afarizëm. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritet të ndërtesës. Kompleksi të organizohet edhe me vend-parkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotualet, terrenet sportive, këndet e lodrave për fëmijë, etj.;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

**V. Kompensimi / shpronësimi** me koeficient ndërtimi i parcelës kadastrale nr.588-16 me S=5003.0m<sup>2</sup> dhe nr. 588-23 me S=288.0m<sup>2</sup>; me sipërfaqe totale prej S=5291.0m<sup>2</sup>, të përfshira në gjelbërim të planifikuar, do të mundësohet me koeficient ndërtimi, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, andaj pronarët / investitori, për sipërfaqet e lartcekura do të kompensohen me sipërfaqe ndërtimore S=1058 x 2.6 = 2750.80m<sup>2</sup>.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me koeficient ndërtimi të parcelave dhe pjesëve të parcelave të lartcekura, bazuar në vendimin e lartcekur. Procedura e kompensimit/shpronësimit me koeficient ndërtimi, të pronës private, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarëve të parcelave kadastrale, dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Drejtorja e Pronës, para arritjes së marrëveshjes sipas këtij paragrafi, të konsultojë rregullativën ligjore në fuqi dhe të verifikojë sipërfaqet e sakta të parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale.

Sipërfaqja definitive e shpronësimit/kompensimit me sipërfaqe ndërtimore të trajtohet pas ndarjes, bashkimit dhe barazimit të sipërfaqeve sipas paragrafit V. dhe VI. të këtij Vendimi.

Mos zbatimi i procedurës së paraparë sipas paragrafit 4 të pikës VI, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, do ta obligojë Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VI. Ndarja / parcelimi**, i parcelës kadastrale nr. 588-16 me S=8106m<sup>2</sup>, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese dhe rrugën e planifikuar të Blloku urban "B16" të planit rregullues urban "Mati I", bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet

bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes së parcelave të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes së parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VII. Bashkimi i pjesëve të parcelave kadastrale 588-16 dhe 588-23 ZK Matiçan,** sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, do të bëhet në një parcelë të vetme - parcelë ndërtimore.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e pjesëve të parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VIII. Kycja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**IX. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;

- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdhrukhëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiljarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërimit", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtime dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

**X. Dokumentacioni ndërtime për Masat e mbrojtëse nga zjarri** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtime të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtime, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

**XI. Dokumentacioni ndërtime për Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtime. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

**XII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr. 588-16 dhe 588-23; ZK Matiçan, me sipërfaqe totale brenda vijës rregulluese prej 5291m<sup>2</sup>, në bazë të certifikatave të njësisë kadastrale, janë evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasit 5", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtime, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokave bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtime brenda vijës rregulluese, prej S=7224m<sup>2</sup>. Kjo sipërfaqe do të

regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**XIII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

**XIV. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës**, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

**XV. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore** do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

### **A r s y e t i m**

Pronarëve Betim Tafilaj dhe “Pozhegu Brothers” sh.p.k me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811251032 me investitorin “Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer” sh.p.k me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811432591, me pronar Qazim Asllanaj, me kërkesën 05 nr. 350/02-240306/21 dt. 08.11.2021, për riaplikim të kërkesës së kushteve ndërtimore 05-350/02-120672/21 dt. 25.06.2021, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit afaristo-shumëbanesorë “Rezidenca 4”, gjegjësisht 5 (pesë) ndërtesa, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesat e lartcekura, pronarët dhe investitori kanë prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- *Kopjet e planit dhe certifikatat e njësisë kadastrale për parcelat kadastrale nr. 588-16 dhe 588-23; ZK Matičan;*
- *Informatën nga Plani Rregullues nr. 04-350/01-72493/21 dt. 22.04.2021, lëshuar 06.05.2021 Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës;*



- Akti noterial "Kontratën për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore" të lidhur në mes të Betim Tafilaj dhe inv. "Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer" sh.p.k nga Prishtina, të vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj, M.A me LRP.Nr. 519/21 dt. 08.04.2021;
- Akti noterial "Kontratën për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore" të lidhur në mes të "Pozhegu Brothers" sh.p.k dhe inv. "Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer" sh.p.k nga Prishtina, të vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj, M.A me LRP.Nr. 18426/21 dt. 06.12.2021;
- Kopje e aktia noterial "Autorizim i përgjithshëm për përfaqësim" me të cilin inv. "Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer" sh.p.k nga Prishtina autorizojnë Berat Bequku dhe Egzon Elshanin për përfaqësim të entitetit biznesor para organeve kompetente, të vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj, M.A me LRP.Nr. 7134/20 dt. 03.08.2020;
- Fotokopjen e pa vërtetuar të certifikatës së regjistrimit të biznesit të kompanisë "Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer" sh.p.k., të regjistruar me nr. 811432591;
- Incizimin gjeodezik të parcelave kadastrale nr. 588-16 dhe 588-23; ZK Matiçan, të punuar nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Januzi, me numër të licencës 105;
- Manualin gjeodezik të bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale, të punuar nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Januzi, me numër të licencës 105;
- Projekti i lokacionit – zgjidhja urbane e punuar nga kompania projektuese N.N.Sh. "CAD partners", me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810902371, me projektues ark. Jeton Shala;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Qazim Asllanaj, nr. 223098/21 dt. 19.10.2021;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Betim Tafilaj, nr. 113853/21 dt. 18.06.2021;
- Fotokopjet e letërnjoftimit të pronarit Betim Tafilaj;
- Foto të lokacionit;

Kjo Drejtori, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për zonën në fjalë dhe legjislacionit në fuqi, ka konstatuar se, për këtë çështje janë zhvilluar procedurat administrative të cilat në mënyrë kronologjike do të paraqiten si në vijim:

Pronari Betim Tafilaj me investitorin "Vllëzërit Asllani dhe Rroni Fer" sh.p.k me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit me nr. 811432591, me pronar Qazim Asllanaj, 05 nr. 350/02-240306/21 dt. 08.11.2021, kanë kërkuar nga kjo drejtori riaplikimin e kushteve ndërtimore 05-350/02-120672/21 dt. 25.06.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin kompleksit afaristo-shumëbanesorë "Rezidenca 3", gjegjësisht 5 (pesë) ndërtesa: "Ndërtesa B16/01" me etazhitet 2B+P+7, "Ndërtesa B16/02" me etazhitet 2B+P+8, "Ndërtesa B16/03" me etazhitet 2B+P+8, "Ndërtesa B16/04" me etazhitet 2B+P+7 dhe "Aneksi B16/A" me etazhitet 2B+0, në kuadër të tërësisë "L", të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 588-16; ZK Matiçan.

Drejtorja e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës, 05 nr. 350/02-240306/21 dt. 08.11.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore, dokumentacionin e prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për atë hapësirë, rregullativën ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit & procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumentacionit të prezantuar dhe trajtuar gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, konstatoi se:

Kjo Drejtori pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim, Nr.04/L -110 dhe UA të MMPH-së Nr.06/2017 në dt. 05.08.2021 deri me dt. 20.08.2021, ka vendosë "Njoftim publik" për njoftimin dhe mundësin e dhënien së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m'. Ky njoftim ka qëndruar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në email adresat e vendosura në njoftimin publik, që nënkupton se kjo drejtori mund të vazhdoj me procedurat e caktimit të kushteve ndërtimore.

Poashtu, pala sipas shkresës "Plotësim dokumentacioni" me nr. ref. 05-350/02-120672/21 dt. 25.06.2021 të datës 19.08.2021, nga pala është kërkuar të përfshihet në zgjidhje urbane edhe parcela kadastrale 588-15; ZK. Matiçan e cila mundëson qasje në rrugë të planifikuar dhe në mungesë të prezentimit të marrëveshjes kërkesa është refuzuar me vendim nr. 05-350/02-120672/21 dt. 29.09.2021. Në ndërkohë pala me kërkesën për riaplikim ka prezentuar edhe kopjen e planit, certifikatën dhe marrëveshjen për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore me



pronarin e parcelës nr. 588-23; ZK. Matiçan, kërkesë kjo e plotësuar për të vazhduar me procedurat e mëtutjeshme.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit dokumentacionit të prezantuar, identifikimit të gjendjes faktike të lokacionit në teren, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për lokacionin, rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, procedurat e zhvilluara gjatë fazës së trajtimit të kërkesë me konstatimet e lartcekura, konstatoi se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore dhe të dokumentit të planifikimit hapësinor për miratimin e projekt propozimit – “zgjidhjes urbane”, të prezantuar në harmoni me kriteret e planit urbane në fuqi, sipas kriterëve dhe kushtet e përcaktuara në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacionit -"zgjidha urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse, Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregullues dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Mati 1" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali gjeodezik për ndarje dhe bashkim.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**Ky Vendim është përpiluar në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkueseve, në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-240306/21 dt. 08.11.2021, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me Qytetarë.


**Përmes postës elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 nr. 350/02-240306/21 DT. 03.12.2021**

Zyrtare,  
Marigona Gashi



u.d.Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtor i Drejtorisë,  
Andrian Olluri








Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# Dispozita Urbane - Ndarja me vijë rregullative dhe gjelbruese ZK Matiçan , Parcela 588-16 dhe 588-23


Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njohov opis

Nr	Y	X
1	7515349.872	4723637.734
2	7515349.898	4723637.694
3	7515353.278	4723632.473
4	7515372.071	4723603.466
5	7515400.182	4723560.445
6	7515405.826	4723552.138
7	7515380.660	4723513.140
8	7515372.777	4723500.542
9	7515372.716	4723500.444
10	7515368.880	4723494.312
11	7515356.624	4723474.723
12	7515354.388	4723478.131
13	7515345.770	4723490.460
14	7515330.070	4723512.900
15	7515327.873	4723516.041
16	7515307.320	4723546.590
17	7515302.882	4723553.182
18	7515315.483	4723573.007
19	7515324.552	4723587.276
20	7515321.753	4723592.310
21	7515321.728	4723592.355



Rilevoi Ibrahim Junuzi  
(emri dhe mbietmri i gjeodeti)

Nr. i licencës : 105



Nënshkrimi [Signature]

Data e rilevimit 03.12.2021














Biloku B16

**LEGJENDA:**

-  Parcela ndertimore S = 5291.0 m<sup>2</sup>
-  Sipërfaqe gjelbëruese e parcelës ose 30% e parcelës ndertimore S = 1587 m<sup>2</sup>
-  Sipërfaqe gjelbëruese (kulm i gjelber) ose 10% e parcelës ndertimore S = 530.02 m<sup>2</sup>
-  Sipërfaqe e perdhesses dhe suterrenit ose 35.34% e parcelës ndertimore S = 1870.0 m<sup>2</sup>
-  Sipërfaqe e parterit dhe rugeve ose 34.7% e parcelës ndertimore S = 1835.05 m<sup>2</sup>
-  Sipërfaqe e bodrumit ose 57.83% e parcelës ndertimore S = 3060.02 m<sup>2</sup>
- 



STUDIO PROJEKTISE:  
 N.N.SH "CAD partners"  
 rr. "Muharrem Fejza" C15/13, nr. 10 / Prishtinë, Republika e Kosovës  
 tel: 044 / 174-742, e-mail: cadpartners.ke@gmail.com

EMERTIMI PROJEKTI: Kompleksi apartis banesor "REZIDENCA 4"

INVESTORI: "Vllazërit Asllan" sh.p.k. - Qazim Asllanaj

FAZA E PROJEKTI: ZGJIDHJA URBANE DATA: Nëntor, 2021

PERMBAJTJA E FLETËS:  
 NDRERTESAT B1601 2B+P+7; B1602 2B+P+8; B1603 2B+P+8;  
 B1604 2B+P+7; ANEKSI B16/A 2B+0  
 SITUACIONI I NGUSHTE

LOKACIONI I PROJEKTI:  
 Zgjidhja urbane - p.rr. "MATI 1" / Biloku urban B\_16, Prishtinë  
 PROJEKTORI: ma.ark. Jeton Shala  
 bashk.ark. Granit Aziri  
 bashk.ark. Blerida Loshaj  
 KONTROLI: ark. Ada Januzi-Cana, Ph.D.




FAZA: **A**




SHKALLA: 1/500

FLETJA NR:

**01**





-  sipërfaqja totale e trajtuar
-  parcelat brenda vijes ndertimore S=5291.0m<sup>2</sup>  
00588-16; 00588-21
-  Sipërfaqja gjelbëruese  
qe hyn ne ndertim nga 20% S=1058.0 m<sup>2</sup>



STUDIO PROJEKTUESE:  
N.N.SH "CAD partners"  
rr. "Muharemin Fejza" C15/13, nr. 10 / Prishtinë, Republika e Kosovës  
Ist: 044 / 174-742, e-mail: cadpartners.ks@gmail.com

EMERTIMI I PROJEKTT:	Kompleksi afarisi banesor "REZIDENCA 4"	FAZA:	A
INVESTTORI:	"Vllazëri Asllani" sh.p.k. - Qazim Asllanaj	SKALLA:	1/750
FAZA E PROJEKTT:	ZGJIDHJA URBANE	FLETA NR:	06
PERMBATJA E FLETES:			
Trajtimimi i parcelave ndertimore sipas gjendjes faktike			
LOKACIONI I PROJEKTT:	Zgjidhja urbane - p.rr. "MATI 1" / Blloku urban B_16, Prishtinë		
PROJEKTORI:	ma.ark. Jeton Shala bach.ark. Gerani Azizi bach.ark. Blerita Loshaj		
KONTROLOR:	ark. Arta Januz-Cana, Ph.D		
DATA:	Nëntor, 2021		
VOJLA E MENJKRIMI:			